



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

---

**P.nr.126/2014**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm**, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtëse Valdete Sadiku, në çështjen penale ndaj të pandehurit Xh.J., nga fsh. ... Komuna e ..., për veprën penale Blerja pranimi apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.3 lidhur me par.2 KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.107/2014, dt.20.07.2017, të cilën aktakuzë e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Sahit Tmava, ka prezantuar i pandehuri Xh.J., mbrojtësi i angazhuar sipas autorizimit av.M.H. nga ..., pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publike, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së, me dt.08.02.2019, është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.06.03.2019

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari;**

**XH.J.**, nga i ati K., e ëma N., e gjinisë M., i lindur me dt. ... në fsh. ... Komuna e ... ku edhe jeton, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., i martuar, prindi i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Me dt.18.02.2014, rreth orës 10:00, në ... ka blerë sendin – automjetin për të cilin ka mundur të dijë që është përfituar në kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që i pandehuri ka blerë automjetin e markës “BMW”X6 35 D ngjyrë e zezë, pa targa të regjistrimit, viti i prodhimit 2009, me nr të shashis ..., nga personi me pseudonimin L. në vlerë prej 15.000 euro, ku i pandehuri i ka kishte dhënë 100euro kapar me qëllim që pjesën tjetër të i jap të nesërmen të cilin automjet e dërgon në shtëpinë e tij, i cili automjet është gjetur nga ana e Policisë përmes të dëmtuarit Z.J. në bazë të GPS-it, të cilit i u kishte aktivizuar alarmi dhe i dëmtuari e kishte lajmëruar policin, i cili automjet përmes Policisë është gjetur në oborrin e shtëpisë së të pandehurit.

**Me këtë ka kryer veprën penale Blerja pranimi apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.3 lidhur me par.2 KPRK-së,**

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,41,45,46,73 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së i;

**S H Q I P T O N**

**DËNIMIN ME BURGIM** në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (2) vite nëse i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër tjetër penale.

Pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civilo juridik.

I akuzuari obligohet të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 100€ aq sa do të jenë sipas listës definitive, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej nga 30€, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.107/2014, të dt.17.07.2014 dhe dt.26.09.2016, ndaj të pandehurit Xh.J. nga fsh. ... Komuna e ... për veprën

penale Blerja pranimi apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.3 lidhur me par.2 KPRK-së.

Në këtë çështje penale gjyqtari ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar dt.20.07.2017, respektivisht dt.29.08.2017, gjatë kësaj seance të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 246 par.1 të KPP-së, janë ndërmarrë veprimet përkatëse juridike në këtë seancë është bërë bashkimi i lëndëve P.nr.126/2014 dhe lëndës P.nr.655/2016, pasi që ndaj të pandehurit janë parashtruar dy aktakuza për të njëjtën çështje penale, lënda është zhvilluar sipas numrit të vjetër P.nr.126/2014 dhe procedura do të zhvillohet sipas këtij numri me kualifikim nga neni 345 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, me tutje është vazhduar me veprimet e tjera procedurale sipas KPP-së, ku i pandehuri është deklaruar se e nuk e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, nga mbrojtësi ka parashtruar kundërshtimi në afatin ligjor, janë marrë vendime nga instancat e tjera gjyqësore, procedura ka vazhduar me seancat e shqyrtimit gjyqësor dt.10.12.2018, 27.12.2018, 08.02.2019, po ashtu me dt.08.02.2019, është bërë edhe shpallja publike e aktgjykimit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari është njoftuar me të drejtat ligjore në këtë çështje penale, në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2,3 të KPP-së.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor dt.08.02.2019, dhe në paraqitjen e fjalës përfundimtare ka deklaruar se në tërësi mbetem pranë aktakuzës ndaj të pandehurit Xh.J. në drejtim të veprës penale me të cilën ngarkohet sipas kësaj aktakuze, duke bërë rikualifikim në fjalën përfundimtare që duhet të jetë se i pandehuri ka kryer veprën penale Blerja pranimi apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.3 lidhur me par.2 KPRK-së, sepse e njëjta u provua nga provat nga të cilat edhe është ngritur aktakuza dhe nga provat gjatë shqyrtimit gjyqësor, andaj nga kjo që u theksua propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë për veprën e kryer penale që i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze dhe ta dënoj sipas ligjit, duke pas parasysh në rastin e caktimit dhe lartësisë së dënimit rrethanat lehtësuese dhe renduese të parapara me ligj.

Prokurori i Shtetit në paraqitjen e fjalës përfundimtare respektivisht në mbështetje të nenit 355 par.3 të KPP-së, pas paraqitjes së fjalës përfundimtare të mbrojtësit dhe të pandehurit, e ka shfrytëzuar mundësin ligjore dhe ka bërë rikualifikimin që duhet të jetë se i pandehuri ka kryer veprën penale **Blerja pranimi apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.3 lidhur me par.2 KPRK-së.**

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të pandehurit Xh.J., av.M.H. ka deklaruar se gjatë këtyre shqyrtimeve konsideroj se në asnjë prove të vetme Prokuroria nuk ka arritur që ti vërtetoj pretendimet e akuzës në mënyrë që do të ia mundësonte gjykatës të sjelle vendimin e saj mbi bazën e standardit të vërtetimit të fakteve përtej dyshimit të arsyeshëm, i mbrojturi nuk e ka mohuar faktin se me një person nga zona e ... është takuar rastësisht se i njëjti i ka ofruar për shitje një veturë për çmimin e së cilës janë marrë vesh paraprakisht dhe se në atë rast ka paguar në emër të kapares shumë prej 100 eurosh, me marrëveshje që pas sjelljes së dokumentacionit shtesë dhe vërtetimit të kontratës, të i'a paguj edhe shumë e mbetur, i mbrojturi im ka përvojë mjaftuar në shitblerjen e automjeteve dhe se sipas vlerësimit të tij çmimin për të cilën kanë arritur marrëveshje, është në proporcion me vlerën e tregut në kohën relevante, posedimi i çelësave të veturës libereza e qarkullimit të së njëjtës i janë dorëzuar aty për aty dhe i akuzuari në asnjë rast nuk ka qenë në mundësi që të ketë mëdyshje se ajo veturë është e përvetësuar nga pronari faktit dhe juridik i saj, nga të gjitha këto mungon elementi konstitutiv i kësaj vepre për faktin se as prokurori dhe as gjykata nuk mundet në menyrë imagjinare të jap përfundim lidhur me ekzistimin e dashjes së të akuzuarit për të kryer një vepër të tillë, fakti se është dhënë vetëm kapara nuk është dhënë çmimi kryesore, pra i akuzuari nuk është vënë në pushtetin juridik të sendit, sepse i ka parapri një veprim i cili do të ishte kusht elementar për ta fituar këtë të drejtë e ajo është kontratë e shitblerjes te çdo prezumim kjo vepër nuk mund të konsiderohet si vepër e përfunduar, sepse ka shumë elemente të mbetjes në tentative, gjykata të merr aktgjykim lirues pasi nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

I pandehuri Xh.J. në paraqitjen e fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbështesë në tërësi deklarin e mbrojtësit tim dhe nuk ka për të shtuar në mbrojtjen e tij.

Në seancën gjyqësore të dt.10.12.2018, ka prezantuar dëshmitari M.Gj. i cili ka deklaruar se i kujtohet rasti, është fjala për një automjetë që është gjetur, atë ditë kam qenë në ndërrimin e natës dhe në mëngjesë rreth ores 06:00, ka adhur personi për të lajmëruar vjedhjen e veturës, i cili automjet ka qenë i vjedhur në Sërbi –Kragujevc, na ka njoftuar se vetura ne atë momentë gjendet në lokacionin e ..., na ka njoftuar se vetura e ka sistemin e GPS dhe përmes operatorit në Begorad me telefonin e tij, e ka drejtuar në këtë lokacion dhe ai ka qenë deri në afersi të fsh. ...Komuna e ... dhe në bazë të telefonit, e kanë njoftuar për lokacionin shumë të afërt ku gjendet vetura dhe na ka kërkuar që sa më shpejtë të veprojmë për me ndaluar që mos të lejojmë që të shkyçet GPS, së bashku me një koleg jemi nisur në drejtim të fshatit ... së bashku edhe me palën, ai tërë kohën ka qenë lidhur me operatorin i cili e ka drejtuar lokacionin ku gjendet vetura, kemi arritur në fsh. ..., kemi vazhduar edhe më tutje në fsh. ... na kanë thënë që të ndalojmë aty, jemi dalur nga vetura dhe me ka drejtuar me gisht në këtë oborr se këtu gjendet vetura, ai lokacion ka qenë në kompetencat e stacionit Jugor në Mitrovicë, kemi njoftuar stacionin policore në Zubin Potok që të thirrret stacioni policor Jugu Mitrovicë, për pak minuta ka ardhur një patroll e policisë, kur ata kanë ardhur ata i kam njoftuar për çfarë është fjala se automjeti është në këtë oborr- lokacion, ata kanë hyrë brenda kanë trokitur, është dalur dikush dhe pas një kohe kolegët na ka njoftuar se vetura gjendet në oborr, nuk kam hyrë brenda në oborr, tani ky raste ka qenë në kompetencë në stacionin Jugu në Mitrovicë, pala ankuese ka mbetur me kolegët e tjerë të stacionit policor Jugu, jam kthyer për në Zubin Potok, më tutje nuk diçka tjetër.

Në seancën gjyqësore të dt.10.12.2018, ka prezantuar dëshmitari A.H. i cili ka deklaruar se janë ftuar nga zyrtarët e stacionit policor të Zubin Potokut, duke na ka njoftuar se kemi një qytetar i cili dyshon se automjeti i tij ju ka vjedhur dhe sipas kompanisë së sigurimit në Serbi, i janë dhënë informata se këtu afër në një shtëpi në ... mundet të gjendet sipas të dhënave të GPS dhe sipas tyre duke treguar se në cilën shtëpi po dyshohet, kemi shkuar në shtëpinë ku na ka njoftuar se bashku me një kolegë, ka dalur pronari i shtëpisë- Xh.J. e kam njoftuar se një qytetar, një veturë e tij i është vjedhur dhe gjendet në oborin e juaj, i njëjti na ka thënë se një veturë këtu e kam dhe se a është e vjedhur nuk e diçka ka qenë bashkëpunues, kemi hyrë në oborr kemi shikuar është përputhë me përshkrimin që ka thënë qytetari pas e kam njoftuar njësinë e hetimeve, ata kanë ardhur në vendin e ngjarjes dhe më tutje ne nuk jemi marrëur me rast, janë marrëe njësia e hetimeve..

Në seancën gjyqësore të dt.27.12.2018, ka prezantuar dëshmitari I.I. cili ka deklaruar se i kujtohet rasti, është rasti me BMW X6 i cili ka qenë i vjedhur në Sërbi –Kragujevc kjo vjedhje ka ndodhur në Shkurt të vitit 2014 dhe përmes pronarit të automjetit Z.J., përmes GPS e ka identifikuar lokacionin ku gjendet automjeti konkretisht në fsh. ... në shtëpinë e Xh.J., vlera e automjetit sipas ankuesit ka qenë rreth 80.000 euro, ndërsa vet i dyshuari ka deklaruar se vlera është 25.000euro, në momentin kur ka mbërritur në ... është aktivizuar alarmi dhe janë njoftuar policia e Zubin Potokut dhe policia e Stacionit Policor të Jugut Mitrovicë, ku me pastaj e kanë bërë edhe sekuestrimin e automjetit, i dyshimti është intervistuar nga stacioni Jugu i cili është deklaruar se këtë automjete e kishte marrëveshje për shitblerjen e automjetit në shumën prej 15.000euro, që nuk është as i përafërt vlera, ka deklaruar se automjetin e kishte blerë nga një person në ... që nuk ia di emrin, as mbiemri, as adrese, as nr. telefonit përveç pseudonimi L. dhe ka deklaruar se ka dhënë kaparen në shumë prej 100 euro, kemi bërë identifikime përmes Interpolit ka rezultuar se automjeti ka qenë i vjedhur me dt.18.02.2014, është bërë ekzaminimi i automjetit në laboratorin për të vërtetuar a është origjinal apo ka ndërhyrje, automjeti ka rezultuar në rregull nuk ka ndërhyrje, kurse çelësi që është vjedhur ka qenë i falsifikuar edhe brava është vërejt që është hapur me forcë është kuptuar se nuk është në rregull automjeti.

Në seancën gjyqësore janë lexuar provat shkresat dhe atë; raporti me nr. rastit ... i dt. 18.03.2014, vërtetimi i dt. 27.02.2014, në emër të dëmtuarit Z.J., ekspertiza me nr. të rastit referues ... i dt. 01.04.2014, raporti ... i dt.19.02.2014, është bërë vështrim në fotoalbumin e dt.19.02.2014, raporti i dhënë nga policia kufitare i dt. 25.02.2014.

Në këtë çështje në bazë të propozimit të Prokurorit të Shtetit të parashtruar me dt.27.12.2018, është aprovuar propozimi që të kërkohet nga Dogana e Kosovës, të përcaktohet vlera e automjetit si në aktakuzë sipas katalogëve të vitit 2014, dhe me dt.31.12.2018, nga raporti i Doganës së Kosovës Sektori i Vlerës të cilët kanë dhënë mendimin se “malli sikur të ishte vlerësuar në vitin 2014 ka vlerën doganore pa taksa 31.550,00€, ndërsa vlera e veturës pas zhdoganimit do të ishte 40.937,80€”.

Mbrojtësi ka propozuar të caktohet ekspert financiar që të përcakton vlerën e veturës, propozim i cili është refuzuar i pa bazuar, me arsyen se Dogana e Kosovës Sektori i Vlerës e ka përcaktuar vlerën e përfaqësuar prej 31.5550€ që ky automjeti e ka pasur në vitin 2014, nga i pandehuri, po ashtu as nga mbrojtësi nuk është mohuar se automjeti ka vlerë mbi 5000€ dhe element i veprës penale për kualifikim nga paragrafi 3 është se vlera e sendit të jetë mbi 5000€, fakt që nuk mohohet nga asnjëra palë e rastit edhe as nga mbrojtësi i të pandehurit, po ashtu vet i pandehuri e ka pohuar se automjeti sipas vlerësimit të tij se ka vlerë prej 20-25.000€, gjykata e ka vlerësuar të panevojshme që të caktohet eksperti financiar, me arsyet si më lartë.

Pas leximit të provave Prokurori i Shtetit, i pandehuri, mbrojtësi kanë deklaruar se nuk kanë propozime të tjera sa i përket procedurës së plotësimit të provave, shqyrtimi gjyqësor në mbështetje të neni 345 të KPP-së, ka vazhduar me marrjen në pyetje të të pandehurit

I pandehuri Xh.J., gjatë procedurës për marrjen në pyetje në cilësinë e të pandehurit ka deklaruar se do të mbrohet në heshtje në këtë çështje dhe se mbetem në tërsi pranë deklaratës që e kam dhënë në polici, dt.19.02.2014.

Pas procedimit të provave materiale dhe atyre personale në këtë shqyrtim gjyqësor, dëgjimit të dëshmitarëve të konstatuar si më lartë, paraqitjes së fjalës përfundimtare nga palët, mbrojtësi dhe të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera gjykata në mbështetje të nenit 361 par.2 të KPP-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Provat e proceduara si ato materiale dhe ato personale në këtë çështje janë në përputhshmëri me vendimin e marrë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, të konstatuara nga deklaratimet e dhëna dhe të gjitha këto deklarime të dhëna nga ana e dëshmitarëve, janë të qëndrueshme, të mbështetura në prova materiale, andaj gjykata ka krijuar bindjen e plotë duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në vlerësimin e të gjitha rrethanave në mbështetje të provave se pa asnjë dyshim dhe në mënyrë bindëse për gjykatën vërtetohet se në veprimet e të pandehurit janë manifestuar veprime të kundërligjshme në krijimin e elementeve të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, duke e shpallur fajtor të pandehurin për këtë vepër penale siç konstatohet në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata në veprimet e të pandehurit Xh.J., gjatë administrimit të provave është vërtetuar fajësia e të pandehurit për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale neni 345 par.3 lidhur me par. 2 të KPRK-së pasi që në këtë çështje është vërtetuar se i pandehuri ka ndërmarrë veprime të kundërligjshme, duke pasur mbështetje në provat administruar në këtë çështje, kjo vërtetohet nga fakti se i pandehuri ka mundur të dijë se automjeti është përfituar me vepër penale, fakt që mund të vërtetohet se automjeti ditën kur thekson vet i pandehuri se e ka blerë ka qenë pa targa, pastaj fakti i deklaruar nga vet i pandehuri se nuk e ka njohur shitësin, nuk i din as emër e as mbiemër, e din vetëm pseudonimin L., se me të njëjtin është takuar rastësisht, nuk kemi identifikim të personit i cili është shitës, vet mënyra tregon se i pandehuri ka mundur të e dijë, të gjitha këto rrethana e vërtetojnë elementin se i pandehuri ka mundur të dijë se ky automjet është përfituar në mënyrë të kundërligjshme, po ashtu fakti tjetër është edhe vet vlera-shuma e shitjes që pretendon i pandehuri se e ka blerë në shumë prej 15.000€, kur vet i pandehuri e pohon fakti se ky automjet ka vlerë prej 20- 25.000€, ndërsa vlera më e përfaqësuar është 31.5550€, që është konstatuar nga raporti i Doganës së Kosovës, Sektori i Vlerës i datës 31.12.2018, po ashtu veprimet në drejtim të akuzës e vërtetojnë edhe provat tjera materiale nga shkresat e lëndës, raporti i ... dt.19.02.2014, që vërteton faktin se ky automjet ka qenë i vjedhur në Kragujevc Republika e Serbisë dhe ka poseduar targa nr ..., po ashtu nga raporti ... dt.26.02.2014, konstatohet se ky automjet është raportuar i vjedhur me dt.17.02.20-14 rreth orës 22:00 në rrugën ... nr. ..., nga persona të panjohur, vërtetimi i sendeve të sekuestruara të dt.19.02.2014, fotoalbumi dt.19.02.2014, që vërteton vendin ku është gjetur vetura e të dëmtuarit në oborrin e shtëpisë së të pandehurit, verifikimi i automjetit dt.20.02.2014, vërtetimi mbi kthimin e automjetit dt. 07.04.2014, të gjitha këto vërtetojnë akuzën ndaj të pandehurit, në rastin konkret Gjykata në mënyrë të plotë dhe të qartë vërtetoi se janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata në vlerësimin e mbrojtjes së të pandehurit dhe e mbrojtësit e cila mbrojtje i është refuzuar e pa bazuar, mbrojtje e cila është në kundërshtim me provat e procedura në këtë çështje penale të konstatuar më lartë, që rezulton se mbrojtja e të pandehurit dhe pretendimet e mbrojtësit janë të pa qëndrueshme, e mbi bazën e provave të administruara, Gjykata ka krijuar bindjen e plotë duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mbrojtja e të pandehurit dhënë në fazën e procedurës hetimore dhe mbrojtja e tij me heshtje gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykatës një veprim i tillë i paraqitur nga i pandehuri, në konsultim me mbrojtësin, nuk i ka ofruar dëshmi për një gjendje tjetër faktike siç është e parashtruar në aktakuzë nga Prokurori i Shtetit, mbrojtja e tillë në Polici, se “*në dalje të Zubin Potokt në drejtim të kufirit, duke shikuar për dru jam ndal në rrugë dhe e ka vërejtë një xhip, i cili ishte i ndaluar afër një Restoranti në trotuar, afër Xhipit ishte një djal i ri i moshës rreth 24 vjeçar i cili posa më pa, me thirri dhe më pyeti a don me blerë Xhipin,,, .. i njëjti me ka thënë që nëse don me e blerë kushton 15.000€, dhe posa më ka treguar për çmim kam qenë dakord që ta blejë sepse çmimi ishte i volitshëm*”, pastaj deklarimi i të pandehurit “*se nuk e njeh personin me e pa*”, pastaj deklarimi i të pandehurit “*automjeti në tabela të huaja kushton 20-25.000euro*”, një mbrojtje e tillë është plotësisht e pa bazuar nga i pandehuri dhe bëhet vetëm me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe është në kundërshtim me të gjitha provat e administruar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe të gjitha rrethanat e krijojnë bindjen e gjykatës se i pandehuri ka mundur të dijë se automjeti ka qenë i përfituar në mënyrë të kundërligjshme.

Në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të pandehurit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin përjashtuar përgjegjësin penale për të pandehurin në këtë çështje penale në kuptim të nenit 17 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit si rrethanë lehtësuese e vlerësoj, sjelljen korrekte pranë gjykatës, se sendet - automjeti i është kthyer të dëmtuarit, rrethanat familjare i martuar, prindi i 5 fëmijëve, ndërsa rrethana rënduese gjykata e vlerësoj mënyrën dhe rrethanat se si është kryer vepra penale në qëllim të përfitimit material, gjykata ka vlerësuar me bindjen me të plotë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Shpallja e aktgjykimit është bërë me dt.08.02.2019, në seancë të hapur dhe publike, në prezencë të mbrojtësit, në mungesë të të pandehurit dhe në mungesë të Prokurorit të Shtetit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e muar konform neneve 450 dhe 451 të KPP-së, ndërsa lidhur me kërkesën pasurore juridike është vendosur në mbështetje të nenit 461 të KPP-së.

Nga theksimet e theksuara si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i përgjithshëm**

**P.nr.126/2014, dt.06.03.2019**

**Procesmbajtësja  
Valdete Sadiku**

**Gjyqtari  
Bekim Veliqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.